



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



EDHE SAIME DOMAZETI VRITET NË DUART E SHTETIT


 Republika e Kosovës
 Republika Kosovo / Republic of Kosovo
 Prokuratori i Shtetit / Prokuror / State Prosecutor



Prishtinë, dhjetor 2022

Autorë: Arrita Reznici dhe Gzim Shala

Redaktorë: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Departamentit të Shtetit Amerikan - Byrosë Ndërkombëtare për Çështje të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit dhe/ apo UNMIK-ut

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi, nr. 146, Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Përkrahur nga:

Dhjetor, 2022

Prishtinë, Republika e Kosovës



Përmbajtja

1. Përmbledhja ekzekutive.....	4
2. Kronologjia e trajtimit të rastit	5
3. Dështimet e zinxhirit institucional në zbatimin e obligimeve të veta.....	6
4. Jurisprudenca e Strasburgut në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetë	8
5. Mos serioziteti në trajtimin e rastit	10
5.1. Aktakuza “shabllon”	10
5.2. Gati 50 ditë pa zgjidhje për viktimën.....	11
6. Mos adresimi i përgjegjësisë së brendshme nga Prokuroria Themelore në Prizren	12
7. Rekomandimet.....	13

1. Përmbledhja ekzekutive

Më 8 nëntor 2022, në fshatin Kuk, Komuna e Dragashit, Nazire Abdyli dhe Jeton Abdyli në bashkëveprim me njërin tjetrin dhe në shtëpinë e tyre të përbashkët akuzohen se kanë kryer dhunë psikike ndaj të dëmtuarës/ kunatës dhe hallës së tyre Saime Domazeti. Deri më 21 dhjetor 2022, kur Prokuroria Themelore në Prizren kishte ngritur aktakuzë për këtë rast, Prokuroria Themelore në Prizren, Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave dhe Qendra për Punë Sociale në Dragash nuk kanë ndërmarrë veprime shtesë për mbrojtjen e viktimës. Kjo lëndë ishte trajtuar në procedurë të rregullt, pasi Prokuroria Themelore në Prizren nuk kishte iniciuar ndonjë kërkesë për caktimin e ndonjë prej masave për sigurimin e pranisë së personit në procedurë penale.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore, nuk kishte pasur kërkesë për caktimin e ndonjë urdhri mbrojtës për viktimën. Kjo pasi për këtë rast, edhe pse Zyra për Mbrojtje dhe Ndhimë të Viktimave (ZMNV) kishte qenë e njoftuar, nuk kishte bërë fare kërkesë për caktimin e urdhrit mbrojtës sipas Ligjit për Mbrojtje nga dhuna në familje. Qendra për Punë Sociale në Dragash e kishte vizituar viktimën në këtë rast. Kjo Qendër, me arsyetimin se e kishte ditur nga rastet e tjera se strehimoret nuk kanë kushte adekuate për raste si ky, nuk e kishte referuar fare rastin në Strehimore. Këtë nuk e kishte bërë as ZMNV. Disa ditë pas rastit të raportuar lidhur me veprën penale “dhunë në familje”, përkatësisht me 26 dhjetor 2022, viktima Saime Domazeti është gjetur e vdekur. Sipas Policisë, kunata e tani të ndjerës ka pranuar se e kishte kryer krimin.

Konventa e Stambollit, jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerut dhe legjislacioni e aktet e brendshme kërkojnë veprime proaktive institucionale në secilin rast të dhunës në familje. Përkundër kësaj, në rastin e Saime Domazetit, shteti nuk e kishte këtë qasje. Rasti u trajtua në procedurë të rregullt, viktima nuk u referua në strehimore, nuk u kërkua asnjë masë mbrojtëse dhe nuk u gjet asnjë zgjidhje për të ofruar siguri për viktimën. Ky mos veprim i institucioneve përballë njohurisë së tyre për ekzistimin e rrezikut për tanimë të ndjerën, paraqet shkelje të së drejtës për jetë, si e drejta më sublimë, nga e cila rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera.

Këtë mos veprim e ka abstrahuar Prokuroria Themelore në Prizren, duke dhënë vetëm informata rrethore për këtë situatë, por duke mos e adresuar drejt llogaridhënien për këtë rast.

Fatkeqësisht, ky nuk është rasti i parë i kësaj natyre në Kosovë. Ky rast vie gjatë kohës kur Gjykata Kushtetuese është duke e shqyrtuar rastin e vrasjes së Sebahate Morinës, në të cilin rast IKD dhe RrGK kishin gjetur se shteti me mos veprim, e kishte privuar të njëjtën nga jeta, të cilat gjetje ishin konfirmuar edhe nga raporti i Avokatit të Popullit.

Dhuna në familje vazhdimisht thuhet se është emergjencë shtetërore. Fatkeqësisht, në këtë rast, dhe jo vetëm, dështimi zinxhiror i institucioneve bën edhe një herë të qartë se dhuna në familje është duke u trajtuar me mungesë të thellë të profesionalizmit, me mos përgjigje adekuate ndaj këtij fenomeni dhe me mungesë të llogaridhënies nga akterët përgjegjës. Miratimi i politikave, të cilat nuk zbatohen në praktikë, edhe një herë na dëshmojnë se nuk arrijnë asgjë.

2. Kronologjia e trajtimit të rastit

Më 8 nëntor 2022, në fshatin Kuk, Komuna e Dragashit, Nazire Abdyli dhe Jeton Abdyli në bashkëveprim me njërin tjetrin dhe në shtëpinë e tyre të përbashkët akuzohen se kanë kryer dhunë psikike ndaj të dëmtuarës/ kunatës dhe hallës së tyre Saime Domazeti. Në ditën kritike, të pandehurit e lartcekur e nxjerrin nga shtëpia të ndjerën Domazeti, e cila ishte e moshuar dhe me probleme mendore, duke e dërguar për të qëndruar në një pjesë të oborrit (qilar), e kështu i shkaktojnë të njëjtës shqetësim emocional.¹

Policia e Kosovës e kishte trajtuar këtë rast në ditën e njëjtë dhe kishte njoftuar Prokurorin kujdestar dhe Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave. Të njëjtën ditë, Prokurori kujdestar i kësaj Prokurorie ka vendosur që rasti të procedohet në procedurë të rregullt.²

Shtatë ditë më vonë, me 15 nëntor 2022, Policia e Kosovës kishte proceduar kallëzim penal në Prokurorinë Themelore të Prizrenit. Ndërsa nëntë ditë më vonë, kjo Prokurori ka filluar hetimet.³

Deri më 21 dhjetor 2022, kur Prokuroria Themelore në Prizren kishte ngritur aktakuzë për këtë rast, kjo Prokurori nuk kishte ndërmarrë veprime shtesë për mbrojtjen e viktimës. Kjo lëndë ishte trajtuar në procedurë të rregullt, pasi Prokuroria Themelore në Prizren nuk kishte iniciuar ndonjë kërkesë për caktimin e ndonjë prej masave për caktimin e sigurisë së personit në procedurë penale.⁴

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe kohore, ndaj viktimës nuk kishte pasur të shqiptuar asnjë urdhër mbrojtës. Kjo pasi për këtë rast, edhe pse Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave kishte qenë e njoftuar,⁵ nuk kishte bërë fare kërkesë për caktimin e urdhrit mbrojtës sipas Ligjit për Mbrojtje nga dhuna në familje.

Qendra për Punë Sociale në Dragash e kishte vizituar viktimën në këtë rast. Kjo Qendër, me arsyetimin se e kishte ditur nga rastet e tjera se strehimoret nuk kanë kushte adekuate për raste si ky, nuk e kishte referuar fare rastin në Strehimore.⁶

Kështu, në mungesë të veprimeve të institucioneve kompetente, për t'i ofruar mbrojtje sipas dispozitave ligjore në fuqi, Saime Domazeti kishte mbetur në mëshirën e të dyshuarve për kryerje të dhunës ndaj saj.

¹ Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2201-4/22.

² Përgjigja për IKD nga Policia e Kosovës, 28 dhjetor 2022.

³ Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2201-4/22.

⁴ Përgjigja për IKD e Gjykatës Themelore në Prizren, 28.12.2022

⁵ Përgjigja për IKD nga Policia e Kosovës dhe Biseda e IKD me Drejtorin e QPS-së në Dragash, z. Ibrahim Gashi, 28.12.2022.

⁶ Po aty.

Disa ditë pas rastit të raportuar lidhur me veprën penale “dhunë në familje”, përkatësisht me 26 dhjetor 2022, viktima Saime Domazeti ka ndërruar jetë. Sipas Policisë, thuhet se atë ditë, në ora 05:00 policia ka marr informatën se në fshatin Kuk,, KK Dragash ka ndërruar jetë një grua e moshës 67 vjeçare (Saime Domazeti). Trupi i pa jetë është gjet në shtëpinë e saj në fshatin Kuk. Në ora 12:30, mjeku kujdestar i QMF Brodosan, pas kontrollit dhe ekzamenit fillestar në vendin e ngjarjes ka vërejtur se ne trupin e se ndjerës ka dyshime se ka shenja të dhunës. Me qëllim që të sqarimit të shkaktarit të vdekjes nga policia është hap rast “Vdekje e dyshimtë”. Sektori Rajonal i Hetimeve pas kryerjes së ekzaminimit mjekoligjor nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me urdhër të prokurorit kanë ri intervistuar kumatën e viktimës, të dyshuarën N. A e lindur në vitin 1958. Pas ballafaqimit me prova të reja e dyshuara në prezencën e avokatit mbrojtës e ka pranuar se ka kryer vrasjen. Këtë veprim e ka bërë duke përdorur mjete të ndryshme të forta, të cilat më pas i ka fshehur.⁷

3. Dështimet e zinxhirit institucional në zbatimin e obligimeve të veta

Në rastin e raportuar më 8 nëntor 2022, kur Policia ka shkuar në vendngjarje për çka edhe pas disa ditësh ka dorëzuar kallëzim penal në Prokurori për shkak të veprës penale “dhunë në familje”. Sipas raportit të Policisë, tutje është njoftuar Prokuroria Themelore në Prizren, përkatësisht prokurori kujdestar, është kontaktuar Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, si dhe Qendra për Punë Sociale në Dragash dhe rasti me urdhër të prokurorit është trajtuar në procedurë të rregullt.

Me këtë rast, institucionet përkundër obligimeve që i kanë të përcaktuara me dispozita ligjore, Procedura Standarde të Veprimit dhe të definuara edhe në Konventën e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, e zbatuar drejtpërdrejtë në rendin juridik të Kosovës, kanë dështuar të veprojnë në linjë me këto obligime.

Neni 51 i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (Konventës së Stambollit) përcakton shprehimisht obligimet e shtetit përkitazi me vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut. Në paragrafin e parë të këtij neni përcaktohet se “palët marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar që një vlerësim i rrezikut vdekjeprurës, seriozitetit të situatës dhe rrezikut të dhunës së përsëritur të kryhet nga të gjitha autoritetet përkatëse për të menaxhuar rrezikun dhe nëse është e nevojshme për të siguruar mbështetje dhe siguri të koordinuar.”

⁷ “Vdekje e dyshimtë në Dragash ri kualifikohet si “Vrasje e rëndë”, Komunikatë, Policia e Kosovës, 27 dhjetor 2022d. (Shih linkun

<https://www.facebook.com/KosovoPolice/posts/pfbid06cr7rxmfu8fyZSvPsj6zGyGn68eojqiSLJkpM3zVk1pwQiMZnUgS23GjR8k9oCL9l>). (Qasar për herë të fundit më 28 dhjetor 2022).

Por, rrethanat e rastit dëshmojnë se institucionet e përfshira në trajtimin e rastit të Saimë Domazetit nuk kanë bërë vlerësim të duhur të rrezikut, duke mos siguruar kështu masa të nevojshme që do të ofronin siguri dhe mbështetje për viktimën. Në raste të tilla, në veçanti prokuroria e ka për detyrë që të merr masat e nevojshme në përputhje me vlerësimin e rrezikut.

Përkundër se nga të gjitha institucionet e përfshira konstatohet se viktima ka pasur probleme mendore dhe se ka qenë në gjendje të rëndë shëndetësore, asnjë prej tyre nuk ka ndërmarrë veprime konkrete në drejtim të ofrimit të mbrojtjes dhe sigurisë së viktimës. Përkundër faktit se të njëjtit kanë qenë në dijeni se viktima është larguar dhunshëm nga shtëpia, se është vendosur në një qilar në ambient pothuajse të jashtëm, pa përkujdesje, megjithatë kanë dështuar në adresimin e duhur të rastit. Pra në këtë rast edhe pse qartazi është parë se viktima po përjeton një trajtim skandaloz, duke iu cenuar ndjeshëm dinjiteti i saj, nuk kanë vepruar që t'i ofrojnë mbrojtje apo strehim adekuat dhe madje nuk ka pasur koordinim institucional në mënyrë që të hartohet një plan për menaxhimin e rrezikut me të cilin përballet viktima.

Në këtë drejtim, përkundër inicimit të rastit për shkak të veprës penale “dhuna në familje”, nuk ka pasur kërkesë për caktimin e urdhrit mbrojtës për të dëmtuarën, apo kërkesë për caktimin e masës së sigurisë ndaj të pandehurve.⁸ E mbi të gjitha, nuk ka pasur as referim të viktimës në strehimore. Për këtë, nga QPS në Dragash janë përgjigjur se për shkak të gjendjes mendore të viktimës, strehimorja nuk do ta pranonte, sepse ka pasur raste të mëhershme kur nga QPS janë referuar raste në strehimore dhe pastaj nga strehimoret i është kërkuar QPS-së që të tërheqin nga aty viktimat, sepse nuk mund t'i mbajnë për shkak të gjendjes mendore.⁹

Që nga data 8 nëntor 2022 kur është raportuar rasti i dhunës në familje, e deri më 26 dhjetor 2022 kur viktima ka ndërruar jetë, përkundër se kanë qenë në dijeni për rastin, institucionet shtetërore kanë dështuar dhe nuk kanë vepruar në përputhje me obligimet e tyre për të siguruar mbrojtje dhe për të ofruar siguri për viktimën. Përkundrazi, në rrethana të tilla, me një trajtim tejet jo serioz të rastit, ZMNV dhe Prokuroria në Prizren si dhe QPS në Dragash, kanë pamundësuar ofrimin e duhur të sigurisë për viktimën, duke e lënë të njëjtën të vazhdojë të jetojë në një ambient të njëjtë me kryerësit e dhunës, pa përkujdesjen e nevojshme dhe pa i ofruar mbrojtje adekuate.

⁸ Përgjigja për IKD e Gjykatës Themelore në Prizren, 28.12.2022.

⁹ Biseda e IKD me Drejtorin e QPS-së në Dragash, z. Ibrahim Gashi, 28.12.2022.

4. Jurisprudenca e Strasburgut në lidhje me shkeljen e të drejtës për jetë

Nisur nga rrethanat e rastit, Prokuroria Themelore në Prizren e ka ditur ose është dashur të dijë se ndaj tani të ndjerës ekziston një rrezik real vdekjeprurës. Një vrasje në këto rrethana nga jurisprudenca e GjEDNj-së cilësohet si shkelje e të drejtës në jetë, jurisprudencë kjo detyrimisht e aplikueshme në rendin kushtetues dhe juridik të Kosovës.

Jurisprudenca e kësaj gjykate thekson se është detyrim i organeve shtetërore që jo vetëm të përmbahen nga marrja e qëllimshme dhe e paligjshme e jetës, por gjithashtu të ndërmarrin hapat e duhur për mbrojtjen e jetës së individëve brenda juridiksionit të tyre (L.C.B. k. Mbretërisë së Bashkuar, 1998).

“Në rrethana të përshtatshme, zgjerohet gjithashtu një detyrim pozitiv për autoritetet që të marrin masa parandaluese operative për të mbrojtur një individ, jeta e të cilit është në rrezik nga veprat penale të një individi tjetër” (Osman k. Mbretërisë së Bashkuar, 1998; Kontra k. Sllovakisë, 2007; Opuz k. Turqisë, 2009).

Në rastin Osman k. Mbretërisë së Bashkuar (par.116), GjEDNj ka sqaruar saktësisht situatat se kur shteti konsiderohet se ka shkelur obligimet pozitive në raport me të drejtën në jetë: “Sipas Gjykatës, kur ekziston një pretendim se autoritetet kanë shkelur obligimet e tyre pozitive për të mbrojtur të drejtën në jetë në kuptim të parandalimit dhe shtypjes së veprës penale kundër personit, duhet të vërtetohet nëse autoritetet e dinin ose është dashur ta dinin ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një apo më shumë individëve nga veprimet kriminale të një pale të tretë, dhe autoritetet kanë dështuar që të marrin masa brenda fushës së kompetencave të tyre, të cilat masa, gjykuar arsyeshëm, pritej të shmangnin atë rrezik”.

Sipas këtyre standardeve, vrasja e Saime Domazetin është rast tipik i shkeljes së të drejtës në jetë. Nisur nga fakti se Prokuroria Themelore në Prizren që nga data 15 tetor 2022 është në dijeni se Saime Domazetin ka qenë viktimë e dhunës në familje, ndjeshmërinë e viktimës dhe nivelin e dhunës në familje në shoqëri, kjo prokurori detyrimisht është dashur të dijë se ka një rrezik real dhe të menjëhershëm për jetën e saj. Bazuar në dispozitat ligjore, roli i Prokurorit të Shtetit në këtë rast ka qenë që brenda kompetencave ligjore, të ndërmarrë veprime procedurale në drejtim të parandalimit të këtij rreziku. Sikur Prokurori i Shtetit në rastin konkret në përputhje me kompetencat e tij të ndërmerre masat adekuate që e sigurojnë qëndrimin e viktimës larg ushtruesit të dhunës në familje, arsyeshëm besohet se vrasja e Saime Domazetit do të shmangej.

Njëherit, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave përkundër që për këtë rast ka qenë e njoftuar nga Policia e Kosovës, e njëjta nuk ka paraqitur kërkesë për caktimin e urdhrit mbrojtës. Kështu, në rastin konkret, mos veprim institucional në kuptim të përmbushjes së obligimeve pozitive shfaqet edhe nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave.

Po ashtu, duke e supozuar, nga përvoja, mungesën e resurseve të strehimoreve, Qendra për Punë Sociale nuk e kishte referuar fare viktimën në Strehimore. Kështu, viktima kishte mbetur nën mëshirën e të dyshuarve për ushtrim të dhunës ndaj saj.

Për këto arsye, sipas jurisprudencës së GjEDNj-së në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës në jetë.

Për më tepër, pikërisht duke vlerësuar në bazë të këtyre standardeve, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2013 kishte konkluduar se mos veprimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë në rastin e tani të ndjerës Diana Kastrati paraqet shkelje të detyrimeve kushtetuese që rrjedhin nga neni 25 i Kushtetutës dhe neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. “Ka pasur shkelje të së drejtës për jetë...”, thuhej në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Po ashtu, IKD dhe RrGK në mars të vitin 2021¹⁰ kishin gjetur se në shkelje të këtyre standardeve, shteti me mos veprim kishte privuar nga jeta edhe Sebahate Morinës. Këto gjetje ishin konfirmuar edhe nga Avokati i Popullit.¹¹

Për këto arsye, Republika e Kosovës, përkatësisht Prokuroria Themelore në Prizren, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave dhe Qendra për Punë Sociale në Dragash, i kanë shkelur Saime Domazetit të drejtën në jetë, si të drejtën më elementare njerëzore, nga e cila e drejtë rrjedhin të gjitha të drejtat e tjera.

Me këtë qasje, institucionet shtetërore vazhdojnë të mbyllin dyert për çdo viktimë potenciale të dhunës në familje për të adresuar rastet e tyre sipas obligimeve dhe përgjegjësi që ka shteti për të ofruar mbrojtje, siguri dhe ndjekje penale ndaj kryerësve të këtyre veprave penale.

Duke vepruar në këtë mënyrë, dëmi ndaj viktimës, familjarëve të viktimës, sistemit të drejtësisë dhe vetë Republikës së Kosovës tanimë është shkaktuar, dhe e gjitha çfarë mbetet është ndërmarrja e masave urgjente për adresimin e llogaridhënies lidhur me këtë rast. Në këtë drejtim, duhet theksuar faktin se shkelja e të drejtës në jetë ndaj një qytetari, e dëmton edhe vetë imazhin e shtetit të Republikës së Kosovës në kuptim të respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe obligimeve që ka Kosova edhe në raport me zbatimin e Konventës së Stambollit. Aq më tepër, kur këto veprime përsëriten.

¹⁰ Arrita Reznici dhe Gzim Shala, “Shteti me mosveprim privon nga jeta Sebahate Sopin”, Instituti i Kosovës për Drejtësi, 17 mars 2021. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/shteti-me-mos-veprim-privon-nga-jeta-sebahate-sopin/>). (Qasur për herë të fundit më 28 dhjetor 2022).

¹¹ Raporti i Avokatit të Popullit 150/2021, 29 prill 2021.

5. Mos serioziteti në trajtimin e rastit

5.1. Aktakuza “shabllon”

Nga ajo që shihet sipas një vlerësimi aktakuzës së rastit të siguruar nga IKD, rezulton se krahas trajtimit jo të duhur të rastit dhe mosveprimit institucional, edhe ato veprime të pamjaftueshme që janë ndërmarrë në këtë rast, evidentojnë një mosseriozitet të skajshëm.

Në këtë drejtim, aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren me nr. PP/II nr.2201-4/22, përpiluar nga prokurorja Elfete Purova, në përmbajtjen e saj, në fund të aktakuzës ka këtë përfundim: *“Prokurori i shteti duke i vlerësuar të gjitha provat e siguruar në këtë çështje penale, si deklaratën e të dëmtuarit sie dhe deklaratën e të pandehurit të dhëna në prokurori, në video incizimin si dhe shkresat e thera në lëndë, ashtu që duke i vlerësuar ato në lidhshmëri logjike dhe faktike me njëra tjetrën dhe të gjithave së bashku, vërtetohet gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, ku edhe tek veprimet e të pandehurit M.L. plotësohen të gjitha elementet e veprës penale, për të cilën ngarkohet me këtë aktakuzë. Andaj, nga të larcekurat, konsideroj se aktakuza është e provuar dhe në ligj e bazuar”*.

Pra, në rastin konkret, Prokuroria, përkundër që lidhur me rastin ka pranuar kallëzimin penal më 15.11.2022 dhe aktakuzën e ka dorëzuar me 21.12.2022, prapë nuk ka arritur që të njëjtën ta përpilojë në përputhje me dispozitat ligjore, ashtu që përmbajtja e saj të jetë e qartë dhe e saktë. Madje, nga përmbajtja lehtësisht kuptohet se kjo aktakuzë është ngritur e bazuar në një formë (shabllon) të aktakuzës dhe pjesa në fund ka mbetur në tërësi e pandryshuar nga një rast krejtësisht tjetër.

Pra, në pjesën e fundit të aktakuzës, prokurorja e rastit i referohet një të pandehuri dhe jo dy siç i ka rasti. Emri i të pandehurit të shkruar në aktakuzë nuk ka fare të bëjë me të pandehurit që dyshohen për kryerjen e veprës penale dhunë në familje, të cilët akuzohen me këtë aktakuzë. Pra, në pjesën në fund, emri i të pandehurit është me inicialet M.L., përderisa dy të pandehurit e rastit konkret janë Nazire Abdyli dhe Jeton Abdyli.

Tutje, thuhet se prokuroria ka vlerësuar provat e siguruar dhe deklaratën e të dëmtuarit. Kurse, në rastin e të ndjerës Domazeti, në aktakuzë thuhet se deklarata e saj ka qenë *e pamundur të merret, sepse e njëjta ka probleme mendore, është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe ka probleme në të folur*.¹²

Po ashtu, në pjesën e fundit të aktakuzës thuhet se prokuroria ka vlerësuar edhe provat *në video incizimin si dhe shkresat e tjera në lëndë* [...], kurse në rastin konkret nuk ka pasur videoincizim, në shkresat e lëndës. Si provë në këtë rast janë prezantuar vetëm fotografi nga vendi i ngjarjes, të cilat janë realizuar nga zyrtarët policorë të Stacionit të Policisë në Dragash.

¹² Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.2201-4/22, fq. 3.

E gjithë kjo, tregon trajtimin tërësisht joprofesional të këtij rasti edhe në një dimension tjetër. Një formë e tillë e hartimit të aktit akuzues nga ana e Prokurorisë, më së miri e dëshmon mënyrën e trajtimit të këtij rasti nga Prokuroria Themelore në Prizren.

5.2. Gati 50 ditë pa zgjidhje për viktimën

Rasti i raportuar në Polici me 8 nëntor 2022 do të duhej të ishte alarm për ngritjen dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura institucionale drejt adresimit të një rasti të dhunës në familje. Por përkundër kësaj, viktima e rastit, për gati 50 ditë, në gjendje të rënduar shëndetësore dhe me probleme mendore, e paaftë për t'u kujdesur për veten, është lënë në mëshirën e kryerësve të dhunës ndaj saj.

Edhe pse zyrtarët policorë nga afër kanë parë dhe dëshmuar se e ndjera është ndodhur në rrethana jashtëzakonisht shqetësuese, duke jetuar në një qilar në oborr të shtëpisë, në një ambient pothuajse të hapur, në temperatura të ulëta të fund vitit dhe pa qenë në gjendje për përkujdesje vetanake, nuk ka arritur që për të njëjtën të gjejë zgjidhje dhe ta sistemojë në një vend të sigurt.

Procedurat Standarde të Veprimit kanë përcaktuar qartë se ZMNV ka *për detyrë t'i asistojnë viktimat gjatë gjithë procesit.*¹³ [...] dhe se mbrojtësi i viktimave (MV) *e përfaqëson viktimën para institucioneve qeveritare. MV po ashtu vepron si një urë lidhëse ndërmjet viktimës dhe të gjithë akterëve tjerë për ofrimin e shërbimeve përfshirë edhe strehimoret.*¹⁴

Në rastin konkret, ZMNV ka dështuar skajshmërisht në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të veta, duke mos arritur që për gati dy muaj të gjejë një zgjidhje adekuate për viktimën.

Në këtë aspekt, njësoj ka dështuar edhe QPS në Dragash. Përkundër që parashihet se *Qendra për Punë Sociale për të gjitha viktimat e referuara apo identifikuaru bën ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në bazë të vlerësimit të nevojave që ka viktima dhe ka për obligim koordinimin e shërbimeve sociale për viktimën deri te riintegrimi i tij/saj në shoqëri.*¹⁵ [...] *Kjo e mundëson QPS-në të identifikojnë nevojat e viktimës dhe t'i koordinojë shërbimet e duhura*¹⁶, të njëjtit as pas gati 50 ditësh nuk kanë ofruar zgjidhje. Përkundrazi nga QPS kanë deklaruar se edhe pas kësaj kohe, ende kanë qenë në vlerësim të planit se çka të bëjnë, që të gjejnë një zgjidhje afatgjate.¹⁷

Në këtë mënyrë, edhe pasi që trajtimi i viktimës në mënyrë të padinjitetshme dhe rrjedhimisht ushtrimi i dhunës përmes cenimit të dinjitetit të të njëjtës është dëshmuar edhe përmes fotodokumentacionit të Policisë së Kosovës, prapë viktima është lënë të jetojë në të njëjtin

¹³ Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, fq. 38.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty, fq. 41.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Biseda e IKD me Drejtorin e QPS-së në Dragash, z. Ibrahim Gashi, 28.12.2022.

ambient me të pandehurit për kryerjen e dhunës ndaj saj. Prandaj, mos adresimi me kohë dhe mos trajtimi i këtij rasti me seriozitet dhe profesionalizëm nga ana e institucioneve shtetërore kompetente ka çuar në ngjarjen e 26 dhjetorit, kur viktimja edhe ka ndërruar jetë.

6. Mos adresimi i përgjegjësisë së brendshme nga Prokuroria Themelore në Prizren

Përballë gjithë këtij mos veprimi që ka sjellë deri në shkeljen e së drejtës në jetë të Saime Domazetin, Prokurori i Shtetit ende nuk ka njoftuar publikun nëse ka iniciuar ndonjë procedurë të brendshme në mënyrë që të hetohet dhe adresohet përgjegjësia e zyrtarëve kompetentë në këtë rast. Mungesa e llogaridhënies dhe transparencës në Prokurori nuk është risi, porse në raste të tilla do duhej të ishte më e pakta që bëhet si hap i parë.

Në këtë drejtim, Prokuroria Themelore në Prizren, përkundrazi, vetëm ka dhënë informata lidhur me mënyrën se si ka ndodhur vrasja dhe nuk ka informuar nëse është ndërmarrë ndonjë veprim sa i përket mbajtjes llogaridhënës të personave përgjegjës të cilët nuk i kanë kryer detyrat e veta. Kjo Prokurori ka deklaruar se me datë 21 dhjetor 2022, ka ngritur aktakuzë për dhunë në familje ndaj kumatës dhe nipit të Saime Domazetit,¹⁸ Por, në përgjigjet e tyre për media, si Prokuroria Themelore në Prizren ashtu edhe Kryeprokurori i kësaj Prokurorie, Admir Shala, kanë abstrahuar gjithë mos veprimin e Prokurorit të Shtetit, duke mos dhënë asnjë detaj e aq më pak përgjegjësi për këtë situatë. Ndërsa, për këtë rast, Këshilli Prokurorial i Kosovës nuk është deklaruar fare.

Fillimisht, deklarimi para publikut i vetëm Prokurorisë Themelore në Prizren, që nuk e mbulon edhe Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave, është ikje e përgjegjësisë lidhur me mos përmbushjen e obligimeve të Prokurorit të Shtetit.

Në anën tjetër, informimi i pjesshëm i Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren, duke treguar vetëm se me datë 21 dhjetor 2022 ka ngritur aktakuzë për dhunë në familje, kurse në asnjë mënyrë tjetër të komunikimit duke mos shpërfaqur mosveprimet në këtë rast apo të paktën të tregojë se ka filluar hetimet për vlerësimin e mosveprimeve nga ana e zyrtarëve të ndryshëm, është fshehje e dështimeve të kësaj Prokurorie në këtë rast.

Kështu, në deklaratimet e tij publike, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren nuk ka treguar se si është trajtuar ky rast nga momenti kur Prokurori i Shtetit është vënë në dijeni, nuk ka treguar se pse të dyshuarit janë liruar në procedurë të rregullt, pse nuk është kërkuar caktimi i

¹⁸ “Vdekja e gruas në Dragash, Kryeprokurori i Prizrenit tregon për aktakuzat që ishin ngritur para një jave”, Gazeta Express, 27 dhjetor 2022. (Shh linkun <https://www.gazetaexpress.com/vdekja-e-gruas-ne-dragash-kryeprokurori-i-prizrenit-tregon-per-aktakuzat-qe-ishin-ngritur-para-nje-jave/amp/>). (Qasur për herë të fundit më 27 dhjetor 2022).

paraburgimit, pse nuk është kërkuar ofrimi i mbrojtjes, sigurisë dhe strehimit për viktimën etj. Ngritja e aktakuzës, ligjërisht, nuk hyn në kuadër të mjeteve ligjore mbrojtëse të viktimës, të paktën derisa ndaj të pandehurve të merret një vendim i formës së prerë.

Kjo mungesë e hetimit të përgjegjesisë së brendshme për shkak të mos veprimeve të Prokurorisë Themelore në Prizren dhe Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave shpërfaq mungesën e theksuar të llogaridhënies së Prokurorit të Shtetit në raport me viktimën, familjen e saj, viktimat e tjera të dhunës në familje dhe publikut në përgjithësi. Përballë nevojës që Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren të fillojë procedurat për llogaridhënie, sipas autorizimeve të tij në bazë të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i njëjti deri më tani ka abstrahuar mënyrën e trajtimit të këtij rasti, para ngritjes së aktakuzës.

7. Rekomandime

1. U.D. Kryeprokurori i Shtetit, në përputhje me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të iniciojë procedurën disiplinore ndaj të gjithë akterëve të përfshirë në këtë rast, përfshirë edhe Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren.
2. Për mos referim të rastit në strehimore, të adresohet përgjegjësia e Qendrës për Punë Sociale.
3. Institucioni i Avokatit të Popullit të iniciojë hetim përkitazi me këtë rast dhe të dalë me opinion mbi mënyrën e trajtimit të këtij rasti nga institucionet kompetente.
4. Kuvendi i Republikës së Kosovës ta trajtojë vetingun në sistemin e drejtësisë si prioritetin më të lartë në punën e saj.
5. Mos zbatimi i obligimeve në rastet e dhunës në familje urgjentisht të trajtohet nga të gjitha institucionet kompetente.
6. Kuvendi i Republikës së Kosovës të ndajë mjete të mjaftueshme për strehimin e viktimave të dhunës në familje, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara.
7. Krahas të dyshuarës aktuale për vrasje të Saimë Domazetit, Prokuroria Themelore në Prishtinë të hetojë mbi përgjegjësinë penale të të dyshuarit tjetër, i cili kishte qenë i përfshirë në dhunë ndaj viktimës.